



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Njoftim për Shtyp

Mbi rishikimin e dokumentit të Politikës Kombëtare të Konkurrencës

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 24 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ka rishikuar dokumentin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës.

Përmirësimet në këtë dokument pasqyrojnë eksperiencën e një periudhë rreth 12 vjeçare nga fillimi i zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Gjithashtu, janë pasqyruar gjetjet nga procesi i vlerësimit të zbatimit të politikës dhe ligjit të konkurrencës të realizuar nga ekspertët e UNCTAD, proces i kërkuar nga vetë Autoriteti i Konkurrencës, si dhe rekomandimet e Komisionit Evropian të shprehura nëpërmjet raporteve sistematike të progresit.

Legjislacioni aktual mundëson zbatimin e një politike efektive të konkurrencës në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës nëpërmjet veprimit ka shënuar progres të vazhdueshëm në rritjen e kulturës së konkurrencës nga ana e biznesit dhe konsumatorëve si dhe ka dhënë rekomandimet e nevojshme për politikbërësit për aktet që mund të kenë prekur funksionimin e konkurrencës në treg.

Gjatë vitit 2015 Autoriteti i Konkurrencës ka punuar për rishikimin e dokumentit të Politikës së Konkurrencës duke u bazuar në gjetjet e evidentuara gjatë ndërhyrjeve në tregjet, numri i të cilave ka qënë në rritje, përmirësimin e instrumentave hetimorë dhe bashkëveprimin me aktorët e tregut dhe institucionet kryesisht entet rregullatorë për të siguruar një ekonomi funksionale tregu.

Drafti i rishikuar i dokumentit të Politikës së Konkurrencës pasi kalon për një diskutim të gjërë publik, duke synuar gjithpërfshirjen e palëve të interesit nëpërmjet procesit të konsultimit me universitetet, ministritë e linjës, komunitetin e biznesit dhe shoqatat e konsumatorit, studiot ligjore dhe politikbërësit, do të miratohet nga Komisioni i Konkurrencës.